



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

U R D H Ë R

Nr. 167, datë 27.7.2006

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRMINISTROR TË PUNËS,
PËRGJEGJËS PËR PËRGATITJEN, HARTIMIN DHE NDJEKJEN
E ZBATIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË
ZHVILLIMIT RAJONAL, NË KUADËR TË STRATEGJISË
KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës dhe të vendimit nr.692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri””,

U R D H Ë R O J :

1. Ngritjen e grupit ndërministror të punës përgjegjës, për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të zhvillimit rajonal.
2. Ky grup të kryesohet nga ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Zëvendësministrin e Arsimit dhe Shkencës;
 - Zëvendësministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
 - Zëvendësministrin e Shëndetësisë;

- Zëvendësministrin e Brendshëm;
 - Zëvendësministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
 - Zëvendësministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
 - Zëvendësministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
 - Zëvendësministrin e Financave;
 - Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Në mbledhjet e grupit të punës, në varësi të çështjeve, që do të diskutohen, thirren të marrin pjesë:
- titullarët e institucioneve në varësi të ministrive pjesëmarrëse, që do të përfshihen në përgatitjen dhe hartimin e strategjisë;
 - përfaqësues nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj;
 - ekspertë të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Integritimit.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës vepron si koordinator ndërmjet këtij grupi ndërministror të punës dhe Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj, si dhe Ministrisë së Financave e Ministrisë së Integritimit.
5. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ngarkon me detyrën e sekretariatit teknik punonjësin ose njësinë, që siguron mbështetje, teknike dhe logjistike, për grupin ndërministror të punës.
6. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me propozimin e grupit ndërministror të punës, krijon një grup teknik pune, me ekspertë në nivel drejtori ose specialistësh të lartë, nga ministrinë pjesëmarrëse, të kryesuar nga zëvendësministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
7. Për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të zhvillimit rajonal, zbatohen udhëzimet e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri, si dhe manuali “Për përgatitjen e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim,

strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale”, që i bashkëlidhet urdhrit nr.134, datë 12.6.2006, të Kryeministrit.

8. Funkzioni, rregullat e funksionimit dhe detyrat e grupit ndërministror të punës dhe të grupit teknik përcaktohen nga ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përputhje me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
9. Ngarkohet ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Sali Berisha', written over a horizontal line. The signature is fluid and cursive.

SALI BERISHA